



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 25 Prill 2021

Nr: 301

VENDIM

**PËR LIRIM DHE EMËRIM TË ANËTARËVE TË KZAZ NR.13, KZAZ NR. 15, QARKU
LEZHË**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronja “ç”, dhe 2, nenin 32, paragrafi 2, shkronja “d”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V Ë R E N

Në bazë të nenit 32, paragrafi 2, shkronja “d”, të Kodit Zgjedhor, janë kërkuar zëvendësime të anëtarëve në KZAZ-të si më poshtë:

Partia Demokratike, me shkresën nr.4488 prot., datë 25.04.2021, ka kërkuar zëvendësimin e anëtarëve të KZAZ nr.13 dhe KZAZ nr.15, Qarku Lezhë.

Propozimet dhe kandidaturat e paraqitura, plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenet 30, 31, dhe 32, paragrafi 2, shkronja “d”, të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronja “ç”, dhe 2, nenet 30, 31, dhe 32, paragrafi 2, shkronja “d”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSA:

1. Të liroj nga detyra anëtarët z.Mark Frang Lleshi (kryetar) të KZAZ nr.13 dhe z.Ardjan Bajram Reçi të KZAZ nr.15, qarku Lezhë.
2. Të emëroj anëtarët, z.Florjan Ndue Sulaj (kryetar) të KZAZ nr.13 dhe zj.Enkelejda Mark Rica (anëtar) e KZAZ nr.15, qarku Lezhë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen e KQZ-së dhe i njoftohet KZAZ-së përkatëse.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

